



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1042/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A, me NUI: 810514829, me seli në rr. “28 Nëntori”, nr. 181, Lagjja Dardania, në Prishtinë, kundër debitorit “Dukagjini Invest”, me seli në rr. “Bill Clinton p.n, Dukagjini Residence, Lam. A, Kati 10, Nr. 56A Lakrishtë”, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.900/23 të datës 19.06.2023 të Përmbaruesit Privat Valdrin Beka nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 26.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Dukagjini Invest”, ANULOHET urdhri përmbarimor P.nr.900/23 i datës 19.06.2023, i Përmbaruesit Privat Valdrin Beka dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbarimor P.nr.900/23 të datës 19.06.2023 , me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës së kontabilitetit Nr. 016859 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përbushjes së obligimeve të papaguara nga kartela e kontabilitetit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 306.93 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimi, ashtuqë të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të Zyrës Përmbarimore VAIS Law dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe

të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar ndër të tjerash se borxhi i kërkuar nga kreditori është i parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). Ka shtuar se propozimi për përbarim është i mangët dhe nuk i plotëson kushtet ligjore që të llogaritet si propozim i rregullt. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përbarimor si dhe të detyrohet kreditori që t'i bart shpenzimet përbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe se qëllimi i vetëm i saj është prolongimi i procedurës përbarimore. Ka theksuar se në rastin konkret për vlerën e borxhit si në propozim nuk kemi parashkrim të kësaj kërkesë dhe evidentohet fakti se ky borxh nuk është paguar nga debitori. Në lidhje me pretendimet e debitorit se ky urdhër përbarimor nuk përmban elementet e dokumentit të besueshëm e njëjta nuk qëndron, për shkak se dokumenti siç është Libri i shitjeve është dokument i besueshëm dhe përmban të gjitha shënimet për palët në këtë procedurë. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet prapësimi i ushtruar i debitorit kundër urdhrin për përbarim dhe borxhi të ekzekutohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet dhe procedura përbarimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - kartela e kontabilitetit Nr. 016859, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Kartela e kontabilitetit me numër 016859 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitivin e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Bazuar në dispozitën e lartcekur është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Andaj duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbarim është lejuar sipas një dokumenti - kartelës së kontabilitetit në kuadër të Ndërmarrjes Publike Termokos e cila ofron shërbim të ngrohjes, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, përkatësisht kartela e kontabilitetit numër 016859, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin

13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1042/23 datë 26.10.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.